



Nr. 5449

Nr. 626 Prot.

Tiranë më 10.03.2023

Drejtuar : **Qëndrës Kombëtare të Biznesit**

Për dijëni : **Shoqërisë "Johaniteri" Sh.p.k., (Subjekti OSHMA "MCN TV")**

### **Autoritetit të Mediave Audiovizive**

Në Tiranë, sot më datë 10.03.2023,

Unë **Valter Kaçupi**, përmbarues gjyqësor privat pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, i pajisur me certifikatë Nr. 98, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Urdhërit Ekzekutiv Nr. 1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë,

### **KONSTATOVA:**

Se në datë 20.02.2023, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Urdhërit Ekzekutiv Nr.1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lëshuar për titullin ekzekutiv, Vendim me Gjobë Nr. 7, datë 08.06.2021 i Autoritetit të Mediave Audiovizive, me palë:

**Kreditor : Autoriteti i Mediave Audiovizive**

**Debitor : Shoqëria "Johaniteri" Sh.p.k., (Subjekti OSHMA "MCN TV")**

**Me Objekt : pagim gjobe**

Me Vendimin për lëshimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është vendosur:

*"Pranimin e kërkesës së kërkuarit Autoriteti i Mediave Audiovizive.*

*Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e dënimit me gjobë nr.7, datë 08.06.2021, të Grupit të Inspektimit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes pranë AMA-s, të vendosur ndaj shoqërisë "Johaniteri" sh.p.k., me NUIS K521085011.*

*Kundër këtij vendimi nuk mund të ushtrohet ankim."*

Në zbatim të këtij titulli ekzekutiv, me shkresën Nr. 332 Prot., datë 20.02.2022 debitorit i është komunikuar lajmërimi për zbatimin e titullit ekzekutiv në mënyrë vullnetare. Në kushtet kur pas përfundimit të afatit nga ana e palës debitore nuk është shlyer detyrimi, mbi llogaritë bankare të debitorit u vendos masa e sekuestros.

Sa më sipër, në kushtet kur debitori ka shlyer tërësisht detyrimin, bazuar në nenin 616 të K.Pr.Civile, Ligjit Nr. 26/2019 datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat” dhe Udhëzimit “Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbartimor privat”

### URDHËROJ:

- 1- Qëndrën Kombëtare të Biznesit të heqë masën e sekuestros konservative mbi aktivet që debitorët e mëposhtëm zotërojnë të regjistruara pranë jush:
  - Shoqëria “Johaniter” Sh.p.k., Subjekti OSHMA “MCN TV”, me NIPT **K52108501I**, me përfaqësues ligjor **Zj. Marsida Karabollaj**, për ekzekutimin e Urdhërit të Ekzekutimit Nr. 1363 datë 17.06.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke revokuar urdhrin tonë të mëparshëm Nr.502 Prot., datë 02.03.2023.
- 2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

**Përmbartues Gjyqësor Privat**

